

Xhuzepe NAPOLITANO / TETOVA E POEZISË

Biblioteka: HEJZA
Redaktor: Shaip EMËRLLAHU
Recenzent: Migena ARLLATI
Ballina: Majlinda KELMENDI

Xhuzepe NAPOLITANO

TETOVA E POEZISË

Përktheu
Arjan KALLÇO



Tetovë, 2017

*Irenës,
Gabriellës,
Shaipit përgjithmonë,
Verjanës, Julit, Merit,
Elvanës dhe Agronit ende*

POEZI QË VIJNË SI REGJISTRIM I NJË PËRVOJE ME JEHONË TË GJATË

Poezi që flet, duke na vënë përballë, jo vetëm mendime e përsiatje, por edhe veprime të personazheve me të cilët autori poet dialogon. Aty shfaqen njerëzit për të cilët ai nuk mjaftohet vetëm me mendimet dhe ndjenjën, por i duhen më shumë se aq; i duhen veprimet e tyre, hyrje - daljet, shkrimet, fjalët, vështrimet e hedhura dhe shumëçka tjetër, duke e bërë kështu krijimin të qartë e të ndjeshëm me të gjitha shqisat dhe gjymtyrët. Kjo poezi e personazheve që flasin e shprehen, sillen e lëvizin në kontakt me poetin, e bën rrëfimin të prekshëm e real, duke i dhënë atij dimensionin tokësor, dimensionin human (Verjana, Pegnesa, Bija, Finalja, Finalja 2).

Diku në vargje autori nuk heziton të thotë se, kudo që ka poezi, është shtëpia e tij (Parametra). Ndaj i jep të drejtë vetes, kudoqoftë a kudondodhet të krijojë, të shkruajë dhe të gdhendë në vargje secilën përvojë. Kështu do të ndodhë edhe kësaj here, kur ai, në një prej udhëtimeve të tij të shpeshhta,

kësaj rradhe u gjend i ftuar në Maqedoni, në takimet poetike tradicionale “Ditët e Naimit”. A mund t’ia lejojë vetes të qëndrojë pa shkuar dhe sidomos pa shkruar pas një përvoje të tillë, në shoqëri me poezinë dhe poetët e trevave të ndryshme? “Këto shënime udhëtimi kanë shije melankolike”, thotë poeti për shënimet e udhëtimit në fjalë, të cilin e ka shijuar dhe nuk e ka lënë t’i ikë nga duart, pa e përjetësuar mbresën që i la.

Poeti di ta dallojë të bukurën gjithkund. Jo vetëm pse është një njeri me shije të hollë, por edhe sepse vetë poezia e ka bërë t’i shohë gjërat me një sy më delikat se dikush tjetër që nuk e ka ndjesinë e të shkruarit. E ka të pamundur të qëndrojë indiferent ndaj gjinisë së bukur, sidomos kur ajo paraqitet në stadin e brishtësisë: “... flautistet janë tërheqëse në çdo gjatësi gjeografike” (Hapje).

Koha si koncept i së pandalshmes, megjithatë në këto vargje merr dimensionin e realitetit dhe i përshtatet atij. Pavarësisht se shpirti i ri që ruan brenda vetvetes e bëjnë të ndihet në kohë, është mikja Verjana ajo që ia përkujton se koha ka fluturuar, se vitet tashmë janë kthyer në dekada dhe janë shtrësuar mbi rrudha e thinja. Distanca e viteve krijon largësinë mes njerëzve, kujtimet në foto tregojnë se ç’ishin në një të djeshme... dhe ka plot e plot shenja treguese në këtë kohë e cila ikën mizorisht dhe nuk ka të ndalur kurrë.

Thellësia dhe pastërtia shpirtërore del qartë në pah në poezinë me titull “Lioneli”, kushtuar poetit, fitues e triumfues në një rën nga garat e poezisë. E kush e njeh krijuesin më mirë se krijuesi? Për këtë arsye, shfaqen shumë natyrale ndjenjat e butësisë, dashurisë, mirëkuptimit. Poeti sikur dëshiron të tregojë se poetët kanë shpirt më të ndjeshëm se kushdo tjetër, se ata janë njerëz dhe mbinjerëz, janë njerëz në jetën e së përditshmes dhe mbinjerëz në artin e të shkruarit. Pikërisht

për këtë dualizëm, mes njeriut të parë dhe të dytë që shkrihen në një në qenien e poetit, ai na flet disi më shumë në krijimin me titull “Ftohtë”. Ashtu si çdo njeriu, kur bën ftohtë e bie shi, atij i shkon mendja tek mungesa e ombrellës, e kapelës, e beretës, ndërsa si çdo poet, vuan mungesën e miqve të rinj, mungesën e kolegëve të tjetër poetë me të cilët do të kënaqej, duke biseduar dhe ndenjtur në kohën e lirë. Duar-trokitjet, çmimet, po ashtu janë pjesë e jorealit të takimeve letrare, dhe ato bashkë me miqtë mbesin përgjithnjë në sedimentin e ndjenjave njerëzore e poetike.

Kjo dhe shumë të tjera e bëjnë të ndihet ndonjëherë i gJORë, ashtu si të gjithë poetët (Ndihmë). Herë pa të holla, me valixhe herë - herë të humbur, herë nën mërzinë e udhëtimeve, herë të tjera zhytur në trishtim. Dhe ka shumë më shumë se kaq, megjithatë valixhja një ditë do të gjendet dhe po ashtu së shpejti do të vijë një takim i ri mes poetësh.

Ky pozitivitet e bën atë të ndihet i sigurtë që poezinë t’ia lerë trashëgimi vajzës, pasi poezia nuk guxon të vdesë: “urimi i një babai poet:/ iluzion i shpëtimit në të ardhmen/ kur stafeta në duar të mbara kalon” (Bija). Po ashtu ai mendon se poezinë nuk mund ta bëjë çdokush, pasi poezia nuk mund të qëndrojë në fytyra të ngrysur, përkundrazi fytyra e vajzës me plot freski e bukuri është shenjë e qartë se poezia ka mbirë tek ajo. Poezia “Dihatje poetike” paraqet brendësinë më të thellë të autorit të saj. Ai sikur na vë në pëllëmbë të dorës shpirtin e tij dhe na thotë: Ja, ky jam! Është ai dhe poezia. Kur flitet për të, flitet për poezinë e tij dhe anasjelltas, sepse poeti dhe poezia janë një binom i pandashëm, janë një tërësi e vetme që nuk mund të ekzistojnë pa njëri - tjetrin. Poetin e pengon tmerrsisht shumë mungesa e komunikimit (Vështirësi). Ai dëshiron të flasë dhe komunikojë me të gjithë kolegët e tij, pavarësisht nga vijnë ata. Nuk mjafton vetëm që janë mbledhur bashkë në

një aktivitet, por atij i duhet të kuptojë shumë më shumë për shpirtin e tyre, sepse shpirti i poetit është poezia e poetit. Fakti që ai nuk njih anglishten e bën të pamundur shpesh herë të hyjë në komunikim të zgjeruar. Kjo gjë e pengon autorin aq shumë, sa që këtë brengë e ka hedhur në poezi, ndoshta duke vetëfajësuar veten për pamundësinë e komunikimit në gjuhë të tjera.

Poezia “Tri shqiponja” na vë përballë ndjenjën e tundimit. Secili njeri, secili poet, e evidenton lehtë të bukurën, sidomos kur ajo mban emrin femër. Buzëqeshjet, shikimet e përhum-bura drejt bjondeve a bruneve, sado të këndshme qofshin, mund të kthehen në provokime për të humbur ekuilibrin. Sa bukur është t’i përjetosh, por sa vështirë tundimit t’i qëndrosh! Pas kësaj poezie, vjen natyrshëm tjetra, “Cipë”, ku autori na tregon se çfarë vërtetë fshihet brenda shpirtit të tij. Në fakt, askush më shumë se poezia nuk mund ta tregojë siç duhet këtë gjë, ndaj ai i referohet vargjeve sa herë dëshiron të shprehë vetveten. Janë pikërisht ato, vargjet, që e bëjnë t’i trembet takimit, sepse, nëse pikërisht në vargje ka identifikuar mënyrën e sjelljes, tani e ka shumë të qartë se pikërisht ashtu edhe do sillet që në takimin e parë. Është pikërisht ajo, fjala, është pikërisht ai, vargu, që e kanë tradhtuar dhe kanë bërë të ditur të ndodhurën që para se të ndodhte: “... është fjala e poetit që jeton te ty/ dhe që e mugullon qënien/ që as ti nuk mund ta dominosh ...”.

Poezia “Kravatat” i ngre lavde takimit poetik, ku poeti është ndjerë aq mire, sa dëshiron të rikthehet sërish një tjetër herë, se dielli i promovimit e ka zbukuruar jetën e tij zhele. Librat e shkëmbyer, fotografitë, kujtimet do të mbesin gjatë në një memorie që dëshiron të kujtojë, të rikujtojë e, në këtë mënyrë, t’i rijetojë çastet e jetuara.

Autori e di se feja dhe filozofia gjithmonë kanë qenë aleate

me njëra - tjetrën, por ai e zbërthen shumë më lehtë këtë filozofi, kur e sjell të përkthyer nëpërmjet poezisë, e cila po ashtu i qartëson edhe shumë nocione fetare. Takimi me babanë e teqesë (Babai i teqesë) dëshmon se njeriu asnjëherë nuk ka mundur ta identifikojë veten aq thellë, sa të jetë në gjendje ta njohë atë po aq mirë sa ç'është i krijuar dhe i ndërtuar. Ashtu siç ftohen të bashkëjetojnë poetët, njëjtë duhet të ekzistojë toleranca dhe mirëkuptimi fetar mes njerëzve në përgjithësi. Duket e lehtë të gjesh perëndinë Bektashi, por në fakt duhet të kesh fat, pasi thellësia e mendimit dhe meditimit të detyrojnë të shohësh në brendësi që të kuptosh.

Fshehur pas maskës së filozofisë na vjen edhe poezia "Përvojë". Poeti është i bindur se përvoja është bazë në poezi: "... Nëse s'ke të shkuar nuk jeton/ nuk mund të shkruash / nëse nuk ke lexuar më parë...".

Ndërkaq, ndjenja e të ftohtit bën të na dhimbset i gjori italian i jugut, siç e quan ai veten. Ndërdija fsheh brenda saj ndjesi që autori edhe nëse i di, do ta ketë vështirë t'i kontrollojë. "... rrezikon vërtet, ashtu siç rrezikon e guximshmja, apo e pavetëdijshmja..." Shpina e zhveshur e dikujt, çorapet seksi të dikujt tjetër, e të tjera elemente që flasin në heshtje, ia fusin ethet, dhe e bëjnë të kuptojë se ndërdija di dhe flet më shumë, sesa vetëdija.

Kënga "O sole mio" e ngroh, teksa vera e pirë në mbrëmjen e fundit bën që ende ta ketë mendjen të turbulluar. Paksa melankoli është më tepër se ç'duhet e pranishme; ajo vjen e rritet sa më shumë që vitet i shtohen mbi supë. Dhembja për kohën e shkuar, për rininë që nuk është më, për përqafimet që tashmë duhet t'i shmangë, e bëjnë të ndihet më nostalgjik se kurrë. Pavarësisht të gjithave, ende i pëlqen të dëgjojë njërën prej këngëve më të bukura të dashurisë, atë me titull "Dielli im". Është ende gjallë, përjeton ende lindjen e përditshme të

diellit, dhe si i tillë i pëlqen të jetojë secilën ditë të re, qoftë edhe nën melankolinë e gjërave të ikura. Megjithatë është kohë bilancesh, thotë ai në një tjetër krijim, sepse ditët ikin, bashkë me plot mundësi që nuk kthehen më kurrë.

Dhe ashtu papritur vjen koha për t'u kthyer (Kthimi), aktiviteti dhe koha e kaluar me miqtë tani do të jenë një e djeshme, të cilën autori do ta kujtojë me mall ditëve e netëve të vetmisë. Bile edhe në kthim, atij i duket sikur merr me vete gjithçka, edhe miqtë e shokët e takuar rishtazi: "... s'rreshta që t'ju bëja shoqëri/

në këto ditë pa shoqëri/ tani është njëlloj sikur të ktheheshim bashkë..."

Ka ardhur koha e epilogut, atje në Italinë e tij, pa re do të dërgojë mijëra pamje të mbledhura në valixhe, një metaforë kjo e gjithçkaje të paketuar në mendje e zemër.

Dhe më pas çfarë mbetet? Çfarë mbetet pas minutave, orëve e ditëve të kaluara? Mbesin vetëm kujtimet dhe premtimet për një takim të sërishëm, se asnjë miqësie nuk mund t'i vihet kufi, por koha kalon më shpejt, kur mendon se sërish do të ketë një mundësi për t'u takuar. Ky në fund të fundit është edhe koncepti bazë i miqësisë, se miqtë e vërtetë e duan dhe e gjejnë njëri - tjetrin.

I gjithë cikli i poezive konceptohet si pjesëza të një përvoje disaditore, kohë gjatë së cilës lapsi i poetit ka evidentuar momentet më të veçanta, më mbresëlënëse. Ai individualizon shprehjen e tij poetiko - estetike deri në nivelin e një rrëfimi të brendshëm artistic, ku mbizotëron gjuha lakonike, në tentativë për kapjen e momenteve më emocionuese. Instrumenti i përhershëm i këtyre krijimeve mbetet kapja e rrëfimit të momentit, si regjistrim i një përvoje që tashmë ka ndodhur, por që ka lënë gjurmë të përhershme. Për këtë arsye, spektri tematik i këtij vëllimi është i kufizuar, pasi vetë autori ka zgjed-

hur të ketë vetëm një temë preferenciale dhe ekskluzive, atë të takimeve në “Ditët e Naimit”, ndaj kemi të bëjmë me poezi të frymëzimit konkret, duke ruajtur origjinalitetin e konceptit.

Migena ARLLATI

Gjakovë, 5. V. 2017

PROLOG: SË BASHKU

Do ta lexojmë bashkë, kur të kthehem,
këtë ditar dhe a do të arrijmë ndoshta
të buzëqeshim pak (vetëm ne)
për aventurat – e shmangshme? –
që ky udhëtim në Maqedoni ishte
për ne të tre, por që për ju më i keq :
të dënuara të ktheheni në shtëpi, ende
para se të shfaqej gëzimi i herës sonë
të parë bashkarisht!

I dëshiruar, i imagjinuar dhe i shijuar
Tash prej një viti që bashkë ta shijonim
Përvojën e takimit...

Do t'jua tregoj unë, edhe pse i trishtë,
Mes këtyre faqeve që të jem me ju.

VETËM!

Hungari e hidhur! Gabimet
paguhen dhe mendjelehtësitë tona
burokratike jashtë peshojnë shumë!
Udhëtimi i parë i Gabrielës
që, kur po mbyllej, u pezullua
nga gadishmëria maxhare (po ç'të thuash
për injorancën e pakujdesshme në Fiumicino,
por më parë se e jona? Krejt ndryshe
duhej t'i kontrollonim ne,
nëse dokumentet ishin në rregull)!
Tash Festivali im do jetë dy herë jetim:
edhe Irena ka mbetur në Budapest dhe qan
tek kthehet në shtëpi, pa mundur
të debutojë për herën e parë jashtë,
si poete italiane femër! Vetëm
me mendjen tek ju, do të jem tre ditë...

TAKSIA

Çfarë mëkati (paraqitje e kotë)
po shlyejmë me kaq shumë telashe
që na ndodhën sot...

Deri të dielë pa asnjë rrobë-
kostumin tim serioz! –
pa librat e mi dhuratë,
pa dhuratat për fëmijët e Elvanës...
pa ju, familja ime e braktisur
me forë në dhë të huaj.

Të paktën këtu koha është e mirë, ka
një taksist që na merr në aeroport
(Xhuzepja dhe Irena shkruajnë në një fletushkë)
me Lionelin dhe dy amerikanë -
të paktën një spirale qetësie,
pasi e humba edhe valixhen...
Shko dhe gjeje! - më thirri, duke më parë
me sarkazmën e njeriut që i vjen keq
për punonjësin e aeroportit “Aleksandri i Madh”.

HERA E DYTË

Hera e dytë është gjithnjë më e vështirë,
sepse nuk mund të luash me befasinë,
por këta njerëz ende më befasojnë
që e shkrijnë të ftohtin (e pazakontë
edhe për ta, mjaft e parakohëshme)
me një pritje që në siklet më fut pak.

Pothuaj asnjëherë, siç më pëlqen dhe mua,
s'jam i aftë të hapem: kam frikë
të hapem shumë me teprinë
e ruajtur gjatë dhe më pas të prekem,
duke e vënë në siklet atë që më pret...

Emocioni ta gjej të botuar
me kopertinë të bukur Ditët e mia të Naimit
prej Elvanës përkthyer në shqip.
Edhe kështu u dhimbem më shumë...

EMKA

E ke materialin për librin e ri!
thotë Silkeja (disi e ligë), sapo mësoi
për fatkeqësitë që më kishin ndodhur
ndërsa Shaipi i kërkon Verjanës të më qetësojë.
-Ah, sikur të mundte, siç dua unë...

Hoteli është shumë më komod se Liraku
-por kufizohet me periferinë-
Edhe dhoma elegante është gati
për tre, tek më kujton vuajtjet e mia...,
por ka një krimb të vogël mbi mbulesë!

Pamja është e pakët këtë here,
disi larg nga qendra – nuk do të shëtitim
që t'i zbulojmë pamjet e pafajshme
të një bote ndryshe:
duhet të kënaqemi me veten.

PARAMETRA

Këto shënime udhëtimi kanë shijen
Melankolike, ndoshta mund të të krijojë
aventura në një vend të njohur
(sepse kudo që ka poezi, është shtëpia ime),
por edhe pjesërisht ende për t'u zbuluar,

derisa të jesh i sigurtë se ia dhe
koordinatat e drejta ndjenjës
(pa u ndikuar prej parametrave).
Isha i përgatitur që të jetoje
jashtë prej hijes sime, njohjeve
që do të të kishin nxjerrë vërtet në pah
(e vetëdijshme për rolin tënd...)

Pranë teje do të isha poet-
baba që i matur e udhëheq
nxënësen ta njohë vetveten.

HAPJE

Edhe ky vit fillon me fishekëzjarrë
me babain e teqesë dhe lulet për Naimin,
në sheshin para Qendrës kulturore –
Si nxënësit në ditën e parë të shkollës
e vrojtojmë njëri-tjetrin, duke u përpjekur
ta kuptojmë se cili është më i miri.

Ndërkaq me Lionelin jemi pothuaj në shtëpi:
i njeh mirë Xhorxhin dhe Nikolën!
(Edhe Laura qysh fëmijë vinte tek ne
me pushime) dhe si një motër.
Franca më qetëson disi –
ndihem vetëm pak në siklet me gjuhën.

Ka më pak njerëz, por më shumë telekamera
dhe vajzat janë me kostume, duken
të njëjtat si viti i kaluar – flautiset
janë tërheqëse në çdo gjatësi gjeografike
(dhe këtu luajnë operën Karmen!)...

VERJANA

Mos eja shpejt në jetë, nëse më do
në një jetë tjetër – hutëzë - thotë
e reja që më sheh të moçëm
(dhe kush e di – Po! – por të mirë).

Mikja ime, Verjana, tash mund
të bëjë shaka me vitet që fatkeqësisht
na ndajnë, pa ndjerë keqardhje –
përkundrazi është kënaqësi që më bën
ta ndiej më të rëndë largësinë në rritje
nga ç'isha.

Duke e fotografuar pranë monumentit
të librave të vjetër në Universitet
duket sikur i bëj të jetojnë sërisht
me freskinë e gjallërisë së vet
-duke e pranuar, nëse është e mundur vërtet
ta përjetësosh një mësim në letër.

PENGESA

Jo Elvana! Është një zhgënjim tjetër,
por fëmijët kanë temperaturë dhe këtu
koha nuk është për ta-
Dhe ndoshta është mirë që Gabriela as që
nuk është këtu që të ngrijë në lojën tonë.

(nëse çdo pengesë është shpëtim)
-Siç thoshte nëna ime për të më ngushëlluar
me një gjysmë gënjeshtër – sot më duket
se mashtrimet burokratike ia shmangën
torturën vogëlushes së pafajshme)

-sa keq, pasi ajo dallgëzuese
do më jepte me praninë e saj,
ngushëllimin që të flas në gjuhën time,
si disa dhe këtu vetëm pak dinë të flasin.

LIONELI

Poeti i laureuar është aristokrat
(duket sheshit se është në Akademi),
ndoshta nga natyra, apo nga ndarja,
duke u maskuar pa dëshirë
me vështirësitë gjuhësore.
Gjithçka dhe të gjithë e shohin me të folurën
e gjuhës së vet dhe madhësisë franceze,

por fshehtazi është i butë në zemër
(i shpëton ndonjëherë dhe shfaq
dashuri njerëzore, shpirt përshtatjeje
dhe mirëkuptimi të madh
për varfërinë shpirtërore të tjetrit)...

Në buzëqeshjen e vet të përmbajtur,
ndizen drita bashkëpunimi dhe është bukur
të besosh, ta ndjesh në sintoni
të paktën ndonjë shkëndijë poetikë autoritare
në grupin që pas na vjen.

FTOHTË

I ftohti gri – po bie shi dhe s’kam umbrelë
që të mbrohem, por as edhe një kapelë
(sikur ta kisha marrë beretën!) dhe duhet të jem
shumë i kënaqur sesi ecin gjërat këtu
(mes njohjesh dhe përgëzimesh), por
do të desha të isha në shtëpi të mendoja
dhe reflektoja për çka bëjmë.

Këtu ka njerëz vërtet të pushtetshëm
dhe me përvojë në fushën letrare,
ndërsa ne gjithmonë dukemi
të sapombërriturit e rastit (ose nga dashuria?),
por nuk mjafton gjithmonë – nuk më mjafton
të marr herë pas here ndonjë duartrokitje
dhe të vuaj një vit për një mik të ri,
por edhe më shumë për një çmim që
ka peshë...

NDIHMË

Fati i mirë më fut
në taksinë e Nazimit (flet italisht!
sepse ka qënë kamarier gjithandej
-edhe në Afganistan me italianë).

Më shoqëron në aeroport dhe shumë
i sjellshëm më ndihmon të bëj denoncimin
për ta rigjetur përsëri valixhen që e humba...

Ndoshta shumë i ndershëm dhe kur bën llogari,
ose i dhimbsem -mendon : Poetët e gjurë!
(por u zbavitëm kur tregonim
përvoja udhëtimit dhe njohjesh).

Mërzia e udhëtimit nën shiun e imët
e zhyt më tepër në mendime
trishtimin tim – por në kthim
e rifitova besimin
(po, do t'i gjej bagazhet e mia në Fiumiçino!)

HALLE

Lum ai që nuk vuan nga koleseroli
dhe halle të tilla – jo se unë dua
të ha nga dy vezë çdo ditë
(si Armiri me hallet e veta si hebre)
-por do të dëshiroja të mos isha
gjithmonë i vëmendshëm, tek shtirem
se kam ndonjë hall për të cilin
as më vete mendja fare, edhe pse
nuk impenjohem shumë që të përkujdesem.

Ndoshta është e vërtetë se poetët
kanë nevojë (thotë me tepri Besniku)
për ndonjë problem herë pas here që të vuajnë
dhe të jenë mirë, duke u përkdhelur sado pak,
derisa të shkruajnë një poezi
(nuk funksionon gjithmonë, por ndonjëherë)
-unë e di mirë, por mund të mos më duhen
disa alibi, nëse frymëzimin tim kërkoj.

HIPOTEZË

Me mirësjellje Meri më thotë “më vjen keq për gruan tuaj” – por do të ishte më e qetë po të ishte edhe ti këtu që ta kontrolloje çdo lëvizjen tuaj këtu, çdo shikimin tim hipotezë mirëkuptimi, qoftë edhe ndodhi të pavullnetëshme (më shumë se ndjenjat janë vepruese me mendjen...

Në teqenë e Arabatit – puna e denoncimit në aeroport tashmë është zgjidhur – Filloj të nxehem dhe rreshtohem i çlodhur me takime të shumta, të përzemërta (ndoshta edhe ta pranoj ftesën disi keqkuptuese prej lëvizjeve të buta): ndërsa Julja nuk i shmanget lojës sime.

Por dihet se loja është më mirë të zgjatë pak – dhe se është më mirë të mos luash shpesh.

BIJA

Ka një vajzë shumë të bukur Shaipi,
është mëkat që Gabriela të mos e shohë
-ndoshta do të kuptoheshin,
pasi flasim gjithmonë për bukurinë e fëmijëve
me gjuhën universal të zemrave dhe shikimeve
(pa ndonjë rregull që t'ua vërë frerin fantazive
të tyre - të çliruar nga çdo kufizim).

Fytyra e saj me bukuri plot freski
është shenjë se i dhuron poezisë
dimensionin e vet më të sigurtë,
nëse ky shikim i pastër do të flasë
nesër me fjalët e poetit
(është urimi i një babai poet!) :
Iluzioni i shpëtimit në të ardhmen,
kur stafeta në duar të mbara kalon.

QYTETI

Lart e poshtë me taksitë dhe autobusat,
është një shëtitje në vende të ndryshme
(por shohim shumë pak, veç vizitës
në xhaminë “ e ngjyrosur” me galerinë
e artit modern pranë).

Nuk mungojnë vitrinat e ndriçuara
të pasura me ekspozita (në qendër
ka pak rrugë nga qytetit perëndimor-
por pak metra tej pallateve të mbajtur mirë
zbulon për fat të keq gropa uji)
-dhe kafeja për Zhan-Lykun duket e dhuruar,
kur mendon sesa kushton në Bruksel!

Në një vit e përmirësuar, por ende
kjo tokë prej Europës larguar
(ndërtime, ndërtime, ndërtime,
autostrada rreth Shkupit tani)
-e meritojnë dorën e ofruar!

DIHATJE POETIKE

Kur flasin për mua e kuptoj nga tingujt
që të ëmbël i shqiptojnë, por është emri im
-tek shpirti pjesëmarrës që krijohet
nëse flitet për poezinë-

edhe pse në gjuhë të tjera, duket se
fjalët vrapojnë në zemra të padukshme
prej të cilave mezi del një dihatje
që zemra e poetit arrin ta kapë,
të krijojë fjalë të tjera dhe më pas t'i dhurojë:

harmoni e ndjenjave të dashurisë!
Më pas rreshtohem ta dëgjoj
çfarëdo zëri për ta prishur muzikën e saj
(por vazhdoj, sepse të gjithë
duhet të mendojnë
për esperanton – edhe anglishten...

ARABATI

Ndonjë i moshuar tani dremit indiferent,
ndërsa përpiqemi të kuptojmë ndonjë rregull
që shpirt, apo materie pak a shumë të jemi-
çfarë bëjmë, jo çfarë jemi (nuk na duhet
një profet që ta kuptojmë se është e vështirë)
-koherencë e ngatërruar e dëgjimit.

Nëse s'arrin të çlirohesh nga pesha
e burimeve të ethshme, nuk mund të japësh...
Je çfarë jep, jo atë që ke: shumë dakord
– por si të mos tundohesh
tek shpreh interesa apo pasuri
në një shoqëri që nga ana tjetër i fsheh.

Të përfshin Paqja e Arabatit,
edhe pse të lë dyshime se edhe këtu
ndonjëherë duhet të shtiresh, nëse do
ta ruash dinjitetin tek roli (por gruaja
s'ka asnjë rol as këtu:
Sprapset gjithmonë një hap më prapa...

VËSHIRËSI

Nuk nuk e kuptoj gjithçka kur flasin amerikanët mes tyre, apo kur dikush si ta rrumbullakosë anglishten, ashtu si nuk e di ta them, as ta kuptoj nëse nuk lodhen nga ndihma.

Fatmirësisht në fund – të paktën thelbi -kuptohet në një farë mënyre, por është torturë të mos komunikosh përvoja të ndryshme dhe interesante që edhe unë do të desha t'i zgjeroja.

Nuk mund ta provoj anglishten time: do ta bëj tek pres takime të tjera.
– Unë do ta gjej nuk e di sesi me sa vullnet të madh, por e keqja këtu në festival është vështirësia si ta lexojmë njëri-tjetrin.

TRI SHQIPONJA

Në Universitetin e Europës jugore
është një prezantuese bionde në skenë
me të zeza veshur (por Verjana
në hapjen e djeshme shkëlqente në mbrëmje
në ngrohtësinë e paarritshme
të fustanit të saj elegant prej leshi):
Shqiponjat ndonjëherë i kanë sytë e bardhë
dhe akujt i thërrmojnë me një shikim
-apo janë brunet e gjata shtathedhur që
kanë pamje misterioze të ngjarjeve të largëta
si të jetuara në tre jetë – kanë aroma
buzëqeshjesh dhe shikimesh të përhubura:
është e rrezikshme të shtiresh, pasi mund
t'i provokosh majat e paarritshme
(kush më ndihmon ta ruaj ekuilibrin?)

CIPË

Do të shkruaj për ty poezitë më të guximshme
që ta fsheh paturpësinë e ndjenjave të mia
midis fjalëve dhe do të ndjesh turp t'i lexosh,
nëse nuk do kesh dëshirë ta zbulosh,
sesa i rrezikshëm mund të jetë takimi ynë
si poetë përtej çdo barriere.
Sigurisht një dëshmi kjo se gjuha e përbashkët
në poezi ne na bashkon.

Tradhtia - tha Gerardoja u krye
kur lindi fjala, por është fjala e poetit
që jeton te ty dhe që e mugullon qënien
të cilën as ti nuk mund ta dominosh.
Edhe ajo qënie është imja, më përket
e pashprehur jashtë trupit tënd
-e pakapshme jashtë trupit tend.

PJESA E POETIT

Është mbushur plot me studentë amfiteatri
i Universitetit shtetëror të Tetovës
që kurorëzon çmimin
e Lionel Rait që është i qetë,
mesa duket i mësuar me çmimet
që nuk e turbullojnë më shumë se kaq
(ose arrin ta maskojë sjelljen e vet)

Kush e di sesa fjalë do të mbeten,
duke filluar nga këto të miat!
Në veshët dhe në mendjen e atij që dëgjon
-ndoshta edhe me keqardhje-
tjetrin, për të tjera punë i interesuar,
por i detyruar këtu të jetë pjesë
me rol në lojën e subjekteve.

Agroni e ka përgatitur pjesën e vet
e di se çfarë do t'i thotë akademikut,
sesa politike ka në poezi...
Edhe ai vetë pjesëmarrës ai në këtë temë.

BUKUROSHË

Po e thotë më e bukura që je e bukur!
Më i bukur është urimi dhe duhet ta besosh,
edhe pse do të preferoje të ishe e shëmtuar,
por të rrish këtu me ne, së bashku
si një prej grupit poliglot –
e thashë një vit më parë (yshtës
sesa mendjemadh) dhe po e përsërit:
do të përpiqemi që të kemi raste të tjera-
do ta gjejmë mundësinë ta kthehemi prapë.

Do të vish ta njohësh dhe ti të gjorën
Maqedoni bujare
që na pret me ngrohtësinë njerëzore,
për bijtë e vet më të mirë dhe që e kanë
përzemër humanizmin e atyre që mund t'ua japë
në formë poezie – impenjim i përbashkët-
nuk është pak (mendoj për Molizen e vogël)
ku na pret vetë poezia:
është mikpritja që e bën të madhe.

KRAVATAT

E vura kravatën këtë mëngjes
thotë Roberti – si homazh për Jetën zhele
të Shaipit : një kravatë të ndritshme
e kisha dhe unë, por mbeti
në bagazhet e mia të humbura në Fiumiçino!
(faji i nëpunëses së rreptë..)

Pak diell – promovimi
i librit tim bashkë me Jetën zhele,
na dhuroi ditën më të bukur
dhe është kënaqësi tani një fotografi
pranë Naim Frashërit në shesh.

Një fotografi me Shaipin më duhet
për librthin që unë po përgatit,
i përkthyer nga gjuha angleze
prej Elvanës për Odën poetike
-shkëmbim i detyruar dhuratash.
Është bukur kur Elvana bëhet shtyllë
(dy herë përkthyes!) midis nesh.

FJALËT

Një ditë do të mësoj të ushtrohem
të lexoj, duke i gërvishtur fjalët
siç bën Jorgeni – ta shprehim si Agroni
që i bën të ecin me galop të sigurtë

(ti je në rregull – se ke një zë të bukur
je edhe aktore – dhe kërkon tone,
timbre, forma e mënyra të buta
që të lexosh e bindur dhe pa emfazë)

Sigurisht se vështirësitë e shfaqjes
fitohen me pafytyrësi dhe zakone-
dhe siç thotë dikush “më mirë i pari,
pasi i dyti është baraz me të fundit!

Njohje do të thotë të kuptosh,
sesi mund ta mësojmë më mirë
zërin që të kujdeset për fjalët-
por Merit i pëlqen recitimi im...

OMLETA

U dorëzova para omletës,
duke menduar për ty, Gabrielë e pafat,
që rrezikove të jetoje tre ditë si e burgosur
pas prindërve gjithnjë me punë,
pa e patur vëmendjen që ti meriton
-nuk do të ishte një udhëtim qefi për ty
dhe ndoshta do të na kushtëzoje
edhe ne, jo vetëm në tryezë!

Meqë ra fjala, ti nuk e di se këtu hanë
gjithmonë me nxitim me shumë gjëra bashkë
dhe duhet të hash, para se ta kuptosh
cila është më e mira dhe ajo që të pëlqen
më shumë
(pa verë - por me respekt është një krupë,
përkundrazi një përzjerrje shijesh,
por mbizotërojnë (edhe pse me përjashtime
të pranueshme) shije të athta pak të këndshme.

POEZITË E TUA

I pëlqyen Mirzës së re
poezitë e tua Afrika dhe Gaza:
A është vallë e impenjuar në shoqëri? – pyeti
(pak ngushëllim i vogël mungesa jote)
duke shfaqur interes jo të rastësishëm.

Rhemziu dhe Shaipi,
gati të prekur dhe të dashur,
gjatë gjithë kohës pyetën për ty-
a ta kisha dëgjuar zërin dhe si ishte...
la dole të ishte disi e pranishme
mes nesh, ti, debutuese
që e meritoje këtë shpalosje.

Poezitë e tua nuk do ta përshkojnë botën,
por tash i përkasin një grupi miqsh
të gatshëm t'i pranojnë siç janë:
zë i freskët i zgjuarsisë,
zë i përhapur dhe i hapur në botë.

BABAI I TEQESË

Do takohemi – më përshëndeti Babai
sikur ta dinte se prapë do të takohemi
në dimensionin e vet të tolerancës
dhe mirëkuptimit – siç
shpresohet të jenë, jo vetëm poetët,
kur ftohen të bashkëjetojnë këtu,
duke dëshmuar vendosmërinë e qënies së tyre.

Të rilindësh për të qënë një Bektashi?
Por dua ende të jem hulumtues
i së ardhmes që e lashë të rridhte
-bagazh/kujtesë e së shkuarës.

Duket e lehtë ta gjesh Perëndinë Bektashi,
por ndoshta duhet të kesh fat,
nëse je i hutuar në këtë botë dhe ke nevojë
të shohësh ende në brendësi për të kuptuar.

PËRSHËNDETJE DHE DEDIKIME

Poeti danez është ai që më reciton
përmendësh sivjet një tercinë të Dantes,
i bëj jehonë (84! Është më i moshuari),
i lumtur sikur të ishin vargjet e mia!

Me dedikimin e tij Zhan-Lyku më preku,
pasi më shkruan “gruas dhe vajzës tënde
sikur t’i njihte, sikur të kishte patur rastin
t’ju njihte!

Vesna (sa ftohtë! – thotë ndërsa lexon
poezinë tënde), ndoshta
mund të na ftojë në Rijekë
verën e ardhshme – ndoshta ia del
dhe Besniku (ndoshta) na pret në Tiranë...

Lidhim së bashku miqësi, edhe pse
unë jam i vetëm që të përfaqësoj
dhe gëzohem që poezia na bashkon

(sepse në këtë aventurë të keqmbyllur
e di, ti nuk doje, por përse të pendohem?
të paktën nëse del nga guacka jote)

PËRVOJË

Nëse s'ke të shkuar nuk jeton –
nuk mund të shkruash,
nëse nuk ke lexuar më parë:
përvoja është bazë në poezi
(Lioneli e citon vazhdimisht Aragonin –
e ka njohur mirë dhe e konsideron
të pashmangshëm në formimin e tij.
-S'është e shkuar e pabukë Surrealizmi
për mua, për tezën time të teatrit
të Vitrakut rebel është një kredhje pas)
siç është e rëndësishme lidhja e tashme
gjithmonë në kuadrin francez,
mes politikës dhe letërsisë.
Sa keqkuptime dhe kompromise:
miza transportuese ka shumë,
të pranuar, ose të fshehura prej tyre,
prapa maskave të filozofisë.

NDJENJA E TË FTOHTIT

Ndoshta të ftohtit është një ide personale – këtu janë mësuar (koha ndryshon çdo ditë, më thotë kamarieri që flet pak italisht), por edhe nordikët s'kanë më shumë vështirësi se mua, unë i gjori Italiani i Jugut!

Çfarë fishkëllima ere! – Sonte do sëmurem në këtë skenë nga era (më kujtohet se Abdeli rezistoi pak vjet dhe zbriti e u ul në plate): këtu rrezikon vërtet, ashtu siç rrezikon e guximshmja, apo e pavetëdijshmja në detyrën e vet, Verjana e himët, me shpinën e zhveshur por edhe Laura në fushë më fut ethet me çorapet e saj seksi dhe krahët mbuluar.

I PAVEND

Meri e donte skenën
e teatrit të madh dhe qëndroi në plate,
si natën e parë dhe të fundit.
Ndoshta e pyet veten, përse
kaq shumë bukuri (ose tepër
sipas Lionelit, zhbirues si gjithë francezët)
çohen dëm, por dikush
gjithmonë do të ndihet i pavend
dhe përkundrazi dikush të rrijë mënjanë.

Biba është midis publikut (s'është as e pranishme
në antologjinë ku jemi të gjithë ne –
por as Rehmziu që është këtu
nuk ngjitet në skenë)
dhe vetë Shaipit gjithmonë i matur,
i pëlqen të dëgjojë dhe të marrë shënime
në mendjen e vet si regjizor i kujdesshëm –
të cilit i mjafton një shenjë, kur duhet
të afrohet ai që bashkëpunon me të...

FINALJA

Po e mbylлим përsëri derën tek
Qendra kulturore...

Pak publik e humbëm sonte!-
Është mëkat që në mbyllje
janë vetëm besnikët e mbetur –
fëmija e Shaipit dëgjon me vëmendje
e vetëdijshme për rolin që ka si bijë,
aspak e shqetësuar nga gati 12 fëmijët
e ardhur – ishin dhe natën e parë – në biseda!

Tatiana e zbut kitarën
tek na vë muzikë në sfond – Roberti
vazhdon si dhe unë të shkarravitë
në bllokun e tij dhe kush e di se çfarë do dalë,
nëse do na bjerë mot Ditari i tij në dorë...

Julja – e sapofutur në stafin e festivalit
si zonjë shtëpie e zonja, dinamike
dhe e pandjeshme ndaj të ftohtit...

FINALJA DY

Luan në piano dhe është shumë e ëmbël
Laura – na rrëmben me Pulekun në një çast
mirëqënie (melankolia e natës së fundit):
kush e di përse mbyllet gjithmonë në minor...

Nuk është e drejtë! Tatiana e këndon dhe e luan
poezinë e vet dhe duket më e bukur-
si lum ajo që ka mundësi me atë zë...

Djalosh i bukur, bosniaku vë bast me
poeten si djalë të Izraelit
(që më pëlqen si shkruan – për të
të paktën mund ta kuptoj anglishten
dhe i premtova se diçka do t'ia përkthej...

Hristoja, Besniku dhe Zhan-Lyku marrin
duartrokitjet e para si fitues të çmimve
dhe u la takimi vitin e ardhshëm...

Arsimi e përmyll maratonën e vet
të lexuesit shqiptar – u dha të ftuarve
me zërin e tij një tjetër zë platesë
së Tetovës, duke na ofruar vargje.

“O SOLE MIO”

Sa verë! Por është mbrëmja e ndarjes
dhe nuk doja të isha vetëm
që shkon të flejë shpejt (e mbylla mirë
natën e kaluar dhe e zbuta
lodhjen e udhëtimit dhe të hidhërimit)

Tani po ngrohem me “O sole mio”...
Desha të humbesha si dikur,
isha po ai (nuk e ka më moshën!), por
duke rrezikuar ta humbja kontrollin
e zakonshëm:
Ndoshta malinkonia
do më kishte bërë ndonjë shaka të keqe
(e shmanga duke e shmangur përqafimin
e Xhuljas).

Më në fund Kërthiza e Verjanës
në kërcimin tronditës flet, sesa
edhe ajo duhet ta shkarkojë tensionin
e tre ditëve të lodhshme, ku ishte prezantuese
dhe me këtë rast dhe përkthyesë

BILANCE

Mbetëm pak dhe është kohë bilancesh,
por Shaipi ka përse të jetë i kënaqur
(përveç prezantimit në media).
Nëse shpirti i Festivalit është ky
që t'i bëjë të njohur miqtë që shkruajnë
dhe t'i vërë përballë në harmoninë e zërave.

Mund të jetë i kënaqur kush punon,
nëse është fryt i punës një botë e re
e fjalës, e të dëgjuarit dhe e dijes - dhe
nëse kthehemi në shtëpi pak më të mirë,
nëse u bëmë pak si ata që takuam,
dëgjuam dhe njohëm.

I premtova Jetonit t'ia korrigjoj
përkthimin në italisht të vargjeve të tij.
Ditët e Naimit këtë qëllim fisnik kanë,
si besim njerëzor për ta kuptuar
bashkimin e njerëzve dhe të shpirtit.

KTHIMI

Mbi liqenin pa re, shfaqja
Në perëndim të Balatonit është lamtumira
e Ballkanit kur të kthehem – është i kuq
qielli drejt Italisë dhe është shpresë
për të mbërritur sa më pare në shtëpi...

Vendi bosh në krahun tim më thërret hakmarrje,
pasi njëri prej jush e kishte hak:
s’rreshta që t’ju bëja shoqëri
në këto ditë pa shoqëri:
tani është njëlloj sikur të ktheheshim bashkë.

Lajthitë dhe vaferat nuk janë shumë-
por është më mirë ta shmangësh diçka pas tepërisë
së pashmangshme, nëse darkon jashtë shtëpie.
Edhe të papriturat hyjnë në lojë,
të shkaktojë spazma edhe pa buskopanin...

PAK ËMBËLSI

Emocionet e Budapestit nga lart
pjesërisht më ngushëlljnë për hidhërimin
që më japin hungarezët, edhe sot të ngurtë!
(Danubi ëshët një çarje gri...)

Jemi në orar dhe shpresoj të jemi
edhe në mbërritje dhe menjëherë të vrapoj
t'ju përqafoj (edhe pa dhurata
dhe dhuratëza): Hoteli Hemka
është shumë larg nga qendra
për të blerë diçka. Por
edhe në aeroport mund të gjesh vetëm
vogëlimat e njëjta të padobishme.
Shpresoj që të dhuroj pak ëmbëlsi
me “globet e Moxartit”,
atë kur dashuroheshim...

Italia pa re më pret, besoj
me dritat e kush e di ç'vendi
në veri të Romës,
tek po pres ta shoh Fiumiçinon
dhe pistat e tij.

EPILOGU

Gjermania hokatave më fotografon dhe vendos në FB shprehjen napoletane të poetit endacak që nuk reziston dhe këndon, sapo e dëgjon këngën kartolinë të atdheut të vet.

Por fotografitë dhe filmimet këtë vit, të hedhura shpejt në rrjet, do na kujtojnë fytyra dhe zëra se cilët ishim dhe do të na ngjallin dëshirën të vijmë, ose të kthehemi bashkë prapë këtu.

Mijëra pamje të mbledhura në valixhe janë inkurajim për të gjithë ne, sepse secili, nëse ishin vetvetja, kryesisht ka qënë, pasi ishte pjesë e një tërësie (edhe nëse kthehet vetëm në shtëpi).

MË PAS

Jeta dhe punët e zakonshme
do na mbajnë me punë të tjera, ndërsa
premtimet -mos më harro- a do më shkruash?
-do të vij të të takoj: ftomë: të pres-
do të mbeten në gojë vetëm një fjalë.

Ato ditë kaq të ngjeshura pune-
vertet as edhe një orë të qetë
-na lidhën, duke na e zbuluar
të lidhur në një projekt ekzistencial
që quhet liria në formë fjale.

Herën e parë që e lexova historinë tënde, qesha me shpirt, sepse i kujtova të gjitha çastet...mbërritja jote, prania e Julias, Silkes dhe e gjithë bota e tyre kaq komplekse...pastaj e lexova sërish dhe poezia ime e preferuar ishte :”CIPË” ...e përsëri e lexova...dhe mendova...sa mirë që Irena ka fatin të të ketë ty që ia tregon në mënyrë të përsosur ndjesitë e bukura dhe të shëmtuara...Edhe tregimi yt këtu m’u duk më shumë një tregim epik, sesa lirik...sepse lirika të mbeti në gjysmën e udhëtimit...Kush e di si do të ishte, nëse gjërat do të ishin ndryshe...Që ta zbuloj këtë gjë, duhet të kemi një tjetër takim “Ditët e Naimit” (2010): ndoshta prandaj ndodhi gjithçka...Të falenderoj nga zemra, Xhuzepe, që je miku im...

Verjana Abazaj

PËRMBAJTJA

PROLOG: SË BASHKU.....	16
VETËM!.....	17
TAKSIA.....	18
HERA E DYTË.....	19
EMKA.....	20
PARAMETRA.....	21
HAPJE.....	22
VERJANA.....	23
PENGESA.....	24
LIONELI.....	25
FTOHTË.....	26
NDIHMË.....	27
HALLE.....	28
HIPOTEZË.....	29
BIJA.....	30
QYTETI.....	31
DIHATJE POETIKE.....	32
ARABATI.....	33
VËSHIRËSI.....	34
TRI SHQIPONJA.....	35
CIPË.....	36
PJESA E POETIT.....	37
BUKUROSHË.....	38
KRAVATAT.....	39
FJALËT.....	40
OMLETA.....	41
POEZITË E TUA.....	42
BABAI I TEQESË.....	43
PËRSHËNDËTJE DHE DEDIKIME.....	44
PËRVOJË.....	45
NDJENJA E TË FTOHTIT.....	46
I PAVEND.....	47
FINALJA.....	48
FINALJA DY.....	49

“O SOLE MIO”	50
BILANCE	51
KTHIMI	52
PAK ĚMBĚLSI	53
EPILOGU	54
MĚ PAS	55

Xhuzepe NAPOLITANO
TETOVA E POEZISË

Boton:
Manifestimi Letrar Ndërkombëtar
“DITËT E NAIMIT” - Tetovë

Drejtor: Shaip EMËRLLAHU

Lektor: Shefki JASHARI

Korrektor: Ekrem AJRULI

www.ditetenaimit.org

Botimin e ndihmoi
Ministria e Kulturës e R. së Maqedonisë

Tirazhi: 1000 kopje

CIP - Katalogjizimi në publikim
Biblioteka kombëtare dhe universitare “Sv. Kliment Ohridski”, Shkup
821.131.1-1

Tetova e poezisë / Xhuzepe Napolitano, përktheu Arjan Kallço;
- Tetovë: Ditët e Naimit, 2017. - 130 f. : ilustrime; 21 cm.
(Biblioteka HEJZA)

Poezi në gj. shqipe dhe në gj. italiane - Parathënia / Migena Arllati
f. 6-9

ISBN 978-608-4769-05-7
COBISS.MK-ID 103424778

